



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2023:062040

Datë: 24.04.2023

Numri i dokumentit: 04214433

**P.nr.101/2023**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Qemail Suka, në çështjen penale kundër të pandehurve F F nga fshati P, Komuna S dhe P B nga S, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 par.1. lidhur me nenin 31 në lidhje me nenin 77 par. 1 dhe 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.406-11/23 të datës 03.04.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, në prani të Prokurorit të Shtetit Musli Gashi, të pandehurve, dhe mbrojtësit të të pandehurit F F, avokat S. M., me datë 07.04.2023 mori, publikisht shpalli, ndërsa me datë 24.04.2023 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të pandehurit:**

- F F**, nga i ati Xh e ëma R, mbiemri i vajzërisë M, i lindur më -- në fshatin P, Komuna S ku dhe tani jeton, me numër personal ---, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
- P B**, nga i ati V e ëma B lindur më --- në Suharekë, ku edhe jeton në rr. “ A R “, i pa martuar, i papunë, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal ..... **I pandehuri gjendet në vuajtje të dënimit, për një vepër penale tjetër.**

**JANË FAJTOR**

**Sepse:**

Se nga data 30.01.2023 në vazhdimësi deri më 02.02.2023, në intervale të ndryshme kohore, në qendrën tregtare “ B C Sh.p.k “ e cila gjendet në S, pronë e të dëmtuarit A K, të pandehurit F F dhe P B, duke vepruar në bashkëkryerje, me qëllim që vetit t'i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, ia marrin pasurinë e luajtshme të dëmtuarit A K, në atë mënyrë të pandehurit e lartpërmendur, brenda periudhës së lartcekur kohore, në intervale të ndryshme kohore, hyjnë në qendrën tregtare, të cilët pas sigurimit se askush nuk po i vrojtojnë, të njëjtit shfrytëzojnë momentin e volitshëm, dhe brenda periudhës së lartpërmendur disa herë nga raftet arrijnë të marrin pije alkoolike të llojeve të ndryshme, çokollata dhe sende tjera të ndryshme, të cilat

sende i fshehin brenda veshjeve dimërore – palltove dhe më pas pa u vërejtur arrin të largohen nga qendra e lartpërmendur, me të cilat veprime të dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm material.

**Me këto veprime në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi kanë kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 në lidhje me nenin 77 par.1 dhe 2 i Kodit nr.06/L-074 Penal të Kosovës**

Gjykata në kuptim të nenit 4, 7, 17, 21, 31, 38, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 77, 79, 313 të KPRK-së, dhe neni 242, 364, 452 dhe 462 të KPPRK-së, të pandehurve i u shqipton:

## **DËNIM ME BURGIM DHE DËNIM ME GJOBË**

### **I. Të pandehurit F F,**

**Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, dhe dënim me gjobë në lartësi prej 300 euro,**

Në kuptim të nenit 44 të KPRK-së,

Me pëlqimin e të pandehurit dënimi i shqiptuar prej dy(2) muajve burgim, **i zëvendësohet në dënim me gjobë në lartësi prej 400 (katërqind) euro,**

Në aplikim të nenit 76 par. 2 nën par, 2.4 të KPRK-së, i shqiptohet:

DËNIM UNIK ME GJOBË, në shumë prej shtatëqind (700) euro, në të cilin duhet të llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit prej datës 08.03.2023 deri më datë 07.04.2023, e cila gjobë duhet të paguhet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata mundë të ia zëvendësoi dënimin me gjobë në dënim me burgim, duke ia llogaritur një ditë burgimi me 20 euro.

### **II. Të pandehurit P B**

**Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, dhe dënim me gjobë në lartësi prej 300 euro,**

Në kuptim të nenit 44 të KPRK-së,

Me pëlqimin e të pandehurit dënimi i shqiptuar prej dy (2) muajve burgim, **i zëvendësohet në dënim me gjobë në lartësi prej 400 (katërqind) euro,**

Në aplikim të nenit 76 par. 2 nën par, 2.4 të KPRK-së, i shqiptohet:

DËNIM UNIK ME GJOBË, në shumë prej shtatëqind (700) euro, e cila gjobë duhet të paguhet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata mundë të ia zëvendësoi dënimin me gjobë në dënim me burgim, duke ia llogaritur një ditë burgimi me 20 euro.

**III. Detyrohen të pandehurit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, për paushallin gjyqësor të paguajnë shumën prej 20 € (njëzet euro), secili veç e veç, ndërsa në emër të taksës**

për kompensimin e viktimave të paguajnë shumën prej 20 € (njëzet euro), secili veç e veç, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, secili veç e veç.

**IV. I dëmtuari, A K, me adresë në Suharekë, Rr. "A M", lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.**

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, me datë 03.04.20223 në këtë gjykatë ka parashtruar aktakuzë me nr. PP/IL.nr.406-11/23 të datës 03.04.2023, kundër të pandehurit F F nga fshati P, Komuna S dhe P B nga S, për shkak se në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi kanë kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 në lidhje nenin 77 par.1 dhe 2 i Kodit nr.06/L-074 Penal të Kosovës.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 07.04.2023, në prani të prokurorit të shtetit Musli Gashi, të pandehurve dhe mbrojtësit të të pandehurit F F, avokat S. M..

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i pandehuri F F është deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe pas bindjes së gjykatës se i njëjtit e ka kuptuar atë plotësisht, nga gjykata i është ofruar mundësia e deklarimit rreth fajësisë.

I pandehuri F F, është deklaruar se e pranon fajësinë, shpreh keqardhjen për rastin që ka ndodhur dhe premtion që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale.

Mbrojtësi tij, avokati me autorizim, S. M. deklaron: pajtohem me deklaramet e të mbrojturit tim, i cili e ka pranuar fajësinë për veprën penale si ne aktakuzë, pasi që një pranim të tillë e ka bërë vullnetarisht pa qenë i ndikuar, i venë në lajthitje apo në kanosje si dhe pa ndonjë premtim dhe se pranimi i fajësisë është berë pasi paraprakisht i mbrojturi im është konsultuar mjaftueshëm me mua si mbrojtës dhe i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë dhe benifitet e pranimit të veprës dhe se për këtë i propozoj gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë së të mbrojturit tim.

Po ashtu edhe i pandehuri P B është deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe pas bindjes së gjykatës se i njëjtit e ka kuptuar atë plotësisht, nga gjykata i është ofruar mundësia e deklarimit rreth fajësisë.

I pandehuri P B, është deklaruar se e pranon fajësinë, shpreh keqardhjen për rastin që ka ndodhur dhe premtion që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale.

Prokurori i Shtetit nuk ka patur kundërshtime lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve.

Duke u bazuar në deklaramin e të pandehurve për ta pranuar fajësinë në tërësi, gjykata nuk administroi me provat në këtë çështje penale juridike pasi që ka vërtetuar në tërësi gjendjen faktike, se nga data 30.01.2023 në vazhdimësi deri më 02.02.2023, në intervale të ndryshme kohore, në qendrën tregtare " B C Sh.p.k " e cila gjendet në S, pronë e të dëmtuarit A K, të pandehurit F F dhe P B, duke vepruar në bashkëkryerje, me qëllim që vetit t'i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, ia marrin pasurinë e luajtshme të dëmtuarit A K, në atë mënyrë të pandehurit e lartpërmendur, brenda periudhës së lartcekur kohore, në intervale të ndryshme kohore, hyjnë në qendrën tregtare, të cilët pas sigurimit se askush nuk po i vrojtojnë, të njëjtit

shfrytëzojnë momentin e volitshëm, dhe brenda periudhës së lartpërmendur disa herë nga raftet arrijnë të marrinë pije alkoolike të llojeve të ndryshme, çokollata dhe sende tjera të ndryshme, të cilat sende i fshehin brenda veshjeve dimërore – palltove dhe më pas pa u vërejtur arrin të largohen nga qendra e lartpërmendur, me të cilat veprime të dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm material.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimit i fajësisë nga ana e të pandehurve të cilët e kanë pranuar fajin si dhe nga shikimi dhe leximi në: Deklaratën e të dëmtuarit – dëshmitarit A K, të dhënë në polici më 03.02.2023 dhe në prokurori më 16.03.2023, Deklaratën e të pandehurit F F, të dhënë në polici më 08.03.2023 dhe në prokurori në prezencë të mbrojtësit të tij, më datë 20.03.2023, Deklaratën e të pandehurit P B, të dhënë në prokurori në prezencë të mbrojtësit të tij, më datë 20.03.2023, CD me video incizimet me nr. të rastit 2023-GB-..., Raportin e Qendrës Tregtare “ B C Sh.p.k “, për sendet të cilat janë vjedhur dhe shkresat e tjera të lëndës.

Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila iu vihet në barrë e që pranimit i fajit është bërë në mënyrë vullnetare, pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat të pandehurit kanë qenë po ashtu të njoftuar. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimit i fajësisë nga ana e të pandehurve është bërë në pajtim me neni 242 të KPPRK-së dhe nga faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të pandehurve formohen të gjitha elementet e veprës penale Vjedhja nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 në lidhje me nenin 77 par.1 dhe 2 i Kodit nr.06/L-074 Penal të Kosovës.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të pandehurve gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke gjetur si rrethanë lehtësuese pranimit e fajësisë nga ana e të pandehurve, pendimin e tyre të sinqertë dhe zotimin se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra të tilla apo të ngjashme, ndërsa nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, andaj gjykata të akuzuarve i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 76 par. 2 nën par, 2.4 të KPRK-së, me bindje se me dënimet e shqiptuara këtu ndaj të pandehurve, do ta kuptojnë rëndësinë e veprës penale të cilën e kanë kryer dhe në këtë mënyrë të njëjtit do të ndikojnë që në të ardhmen mos të shkaktojë veprime të ndaluara, përkatësisht mos të kryejnë vepra penale. Gjykata vlerësoi se dënimet e shqiptuara si në dispozitivin e këtij aktgjykimit, janë në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesve, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesve, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e tyre, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Konform nenit 79 të KPRK-së , për të akuzuarin F F, gjykata në dispozitiv të këtij aktgjykimi përfshiu edhe kohën e kaluar nën masën e paraburgimit prej datës 08.03.2023 deri më datë 07.04.2023 e cila kohë do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Vendimin për shpenzimet gjyqësore gjykata e bazoi në nenin 452 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi me të cilin të pandehurit janë obliguar të paguajnë taksën për kompensimin e viktimave të krimit , secili veç e veç, është marr konform nenit 36 par.3 nën par.3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit (Nr. 08/L-109).

Gjykata vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, e mori konform nenit 462 par. 2 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**  
**P.nr. 101/2023, datë 24.04.2023**

**G j y q t a r i**  
**Qemail Suka**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit me shkrim të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate